

AKT THEMELIMI

I

SHOQERISE "ALBANIAN INVESTMENT CONSTRUCTION"(A.I.C)shpk

Me vullnetin e lire dhe per interes te perbashket hartohet ky Akt Themelimi midis paleve pjesmarrese si vijon:

- *Vilson Ahmeti*, banues ne Tirane.
- *Alban Peza*, banues ne Tirane.

I cili ka per qellim krijimin e shoqerise tregtare per te ushtruar veprimtari fitimprures, ne perputhje me Ligjin 7638 date 19.11.1992 dhe cdo akt tjetër ligjor e nenligjor qe regullon kete veprimtari ne Republiken e Shqiperise me kete permbajtje:

Neni 1

Emri I shoqerise "*ALBANIAN INVESTMENT CONSTRUCTION*"(A.I.C)shpk
Ortakët themelues: *Z.Vilson Ahmeti dhe Z. Alban Peza*

Neni 2

Objekti I veprimtarise :

- *Veprimtari per organizimin, manaxhimin, ndermjetesimin, investime ne fushen e ndertimit, projekteve dhe supervizionit te plote teknik-ekonomik, nepermjet bashkepunimit me subjekte fizike e juridike porosites dhe sipermarres ndertimi.*

Neni 3

Qendra e shoqerise: Rruga "Deshmoret e 4 Shkurtit" Tirane

Neni 4

Kapitali themeltar eshte ne vlere: 100.000 njeqinde mije leke

Neni 5

Kontributi ne krijimin e tij dhe ndarja e fitimeve ndermjet ortakeve eshte:

Vilson Ahmeti 50%
Alban Peza 50%



Neni 6

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte 10 vjet. Personaliteti juridik I saj fitohet me regjistrimin ne Regjistrin Tregetar prane gjykates se shkalles se pare Tirane.

Neni 7

Administratori i shoqerise do te jete Ortaku Vilson Ahmeti. Kompetencat e tij percaktohen ne statutin e shoqerise dhe Ligjin 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare".

Drejtor Teknik Zonja Aneta Dollani (Zografi).

Neni 8

Organi me I larte I shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve. Menyra e thirrjes se saj dhe kompetencat percaktohen ne statutin e shoqerise dhe ne Ligjin 7638 dates 19.11.1992. "Per shoqerite tregetare".

Neni 9

Shoqeria nuk pergjigjet per humbjet e ortakeve jashte veprimtarise se saj. Shteti nuk perballon humbjet e shoqerise dhe anasjelltas.

Neni 11.

Shoqeria ka te drejte te krijojte dege dhe filiale te saj ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj.

Neni 12.

Kompetente per gjykimin e mosmarveshjeve midis ortakeve, nese ato nuk zgjidhen me pajtim, eshte gjykata shkalles se pare Tirane.

Akti themelimit nenshkruhet me vullnetin e lire te paleve ortake.

ORTAKET

1 Vilson Ahmeti
emri, mbiemri, firma

2 ALBAN PEZA
emri, mbiemri, firma



STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“ALBANIAN INVESTMENT CONSTRUCTION”(A.I.C)shpk

I hartuar me vullnetin e lire te:

- ***VILSON AHMETI***, biri Faikut, dl.1951, banues ne Tirane, rruga Vaso Pasha nr.14/23
- ***ALBAN PEZA***, biri i Ganiut, dl.1970,banues ne Tirane, rruga Labinoti nr.82

mbeshtetur ne dispozitat perkatese te Ligjit 7638 dates 19.11.1992,“Per Shoqerite Tregetare”,Ligjit 7667 date 28.01.1993 “Per Regjistrin Tregetar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregetare”

Me permbajtjen si me poshte:

Neni 1

EMRI,FORMA E SHOQERISE

Krijohet shoqerija “***ALBANIAN INVESTMENT CONSTRUCTION”(A.I.C)shpk*** (shoqeri me pergjegjesi te kufizuar)si person juridik,per te ushtruar veprimtari tregetare me qellim fitimprures, e cila ne baze te nenit 4 Ligjit 7638,dt.19.11.1992,I nenshtrohet legjislacionit ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.Ky statut,nder te tjera percakton formen,kohezgjatjen,emertimin,objektin e veprimtarise dhe shumen e kapitalit themeltar.

Neni 2.

OBJEKTI

Objekti I veprimtarise do te jete:

- ***Veprimtari per organizimin, manaxhimin, ndermjetesimin, investime ne fushen e ndertimit, projekteve dhe supervizionit te plote teknik-ekonomik, nepermjet bashkepunimit me subjekte fizike e juridike porosites dhe sipermarres ndertimi.***

Neni 3

ORTAKET

Ortaket themelues te kesaj shoqerie jane;

Zoti Vilson Ahmeti dhe Zoti Alban Peza.

Neni 4.
QENDRA

Qendra(Selia)e shoqerise:Rruga "Deshmoret e 4 Shkurtit" Tirane
Shoqeria ka te drejte te krijoje dege dhe filiale te saj brenda e jashte vendit.

Neni 5.
KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET

Kapitali themeltar I shoqerise eshte ne vlere 100.000 (njqinde mije)leke.

Pjeset e tij nenshkruhen dhe shlyhen teresisht nga dy ortaket pjesmarres,nepermjet depozitimit te fondeve,qe vertetohet nga certifikata e mbajtesit te tyre per llogari te shoqerise ne formim e siper. Kontributet e ortakeve per krijimin e tij jane ne kuotat perkatesisht:

Zoti Vilson Ahmeti 50% dhe Zoti Alban Peza 50%

Neni 6.
KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte 10 vjet.Shoqeria fiton personalitetin e saj juridik me rregjistrimin ne Regjistrin Tregetar,prane gjykates se shkalles se pare Tirane.

Neni 7
ORGANET VENDIM MARRESE TE SHOQERISE.
PJESMARRJA NE VENDIME

Organi me I larte vendim marres I shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve.Mbledhjet e saj jane te zakonshme (jo me pak se tre here ne vit) dhe te jashtezakonshme. Drejtimi I mbledhjeve te shoqerise,behet nga Administratori i shoqerise.


Te drejten e thirrjes se saj e ka secili ortak.Cdonjeri prej tyre ne mungese, mund te perfaqesohet ne Mbledhjen e Asamblese nga perfaqesues me akt te posacem duke percaktuar shprehimisht tagret e dhena siper rendit te dites.

Cdo ortak disponon nje numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron.

Neni 8.
ADMINISTRIMI

Drejtimi I shoqerise kryhet nga administratori i saj, Ortaku Vilson Ahmeti zgjedhur nga mbledhja e pare e Asamblese.

Ai ushtron kompetencat e dhena nga statuti dhe neni 16,50 te Ligjit 7638 date 19.11.1992, me perjashtim te atyre qe ky ligj ua nje shprehimisht ortakeve.



Administratori perfaqeson shoqerine ne marredhenie me te trete dhe shoqeria merr persiper detyrimet qe rjedhin nga aktet e nenshkruara prej tij. Administratori detyrohet te respektoje procedurat e njoftimit te mbledhjes se ortakeve, duke njoftuar 15 dite me pare per daten, oren dhe rendin e dites se mbledhjes. Ai paraqet raportin e llogarive perfundimtare vjetore apo cdo projekt te hartuar nga eksperti kontabel I emeruar nga mbledhja e ortakeve.

Drejtor Teknik inxh. Aneta Dollani (Zografi).

Pergjegjesia e Administratorit.

Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise per shkelje te ligjeve, te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te saj.

Ortaku tjetër ka te drejte t'i drejtohet gjykates kompetente per shkarkimin e Administratorit per veprime te kryera qe bien ndesh me ligjin, duke kerkuar kur eshte e nevojshme edhe shperblim te plote te demit financiar te shkaktuar.

Neni 9.

**BILANCI, VITI FINANCIAR,
E DREJTA PER INFORMIM.**

Viti financiar perfshin periudhen nga data 1 janar deri ne date 31 dhjetor te cdo viti. Llogarite vjetore, inventari, Raportet mbi operacionet e vitit financiar, miratohen nga Asambleja e Ortakeve. Keto te fundit I nenshtrohen miratimit brenda 6 muajve duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar (neni 56, Ligji 7638, date 19.11.1992). Ortaku joadministrator ka te drejte t'i vihen ne dispozicion aktet e mesiperme per shqyrtim e te paraqese pyetje me shkrim .

Neni 10.

EKSPERTI KONTABEL

Shoqeria mund te emeruje Ekspert Kontabel te autorizuar, me vendim te Asamblese, per nje periudhe prej 6 vite financiare. Ai ngarkohet me mbajtjen e Kontabilitetit te shoqerise dhe e ushtron kete funksion ne menyre te pavarur nga veprimtaria e shoqerise. Per emerimin e tij respektohen edhe dispozitat 168,169 te Ligjit 7638 date 19.11.1992, ne lidhje me: perjashtimin dhe papajtueshmerite.

Modalitetet e emerimit, kompetencat, funksionet e tij percaktohen ne Ligjin cituar me lart. Eksperteti kontabel njoftohet per mbledhjet e Asamblese si dhe lejohet te marri pjese ne te.

Eksperti kontabel I autorizuar detyrohet vecanerisht:

- Te garantoje qe llogarite vjetore jane te rregullta dhe te hartuara me korrektese, qe japin nje pasqyrim besnik te rezultatit te operacioneve te vitit te kaluar financiar si dhe te gjendjes financiare te trasheguar te shoqerise ne fund te vitit financiar ne vazhdim.
- Te verifikoje librat e llogarise dhe te fondeve te shoqerise dhe pershtatjen e kontabilitetit te saj me legjislacionin ne fuqi.
- Te verifikoje perputhjen me llogarite vjetore te informacioneve te dhena nga raporti I Administratorit.



- Te kryejë kontrollet që i cmon të nevojshme dhe të dobishme dhe në vecanti kontratat, librat e llogarise, dokumentat kontabel dhe rregjistrat e procesverbaleve.
- Te mbledhë informacione të cilat i quan të dobishme prane të tretteve, që kanë kryer operacione financiare me shoqerine .Te vejë në dijëni Ortaket në mbledhjet e Asamblese së shoqerise për rastet e përrëgullshmerive dhe pasaktësive që ka konstatuar.
- Te ruajë sekretin profesional lidhur me fakte, akte dhe informacione për të cilat është mundur të vihet në dijëni për shkak të ushtrimit të këtij funksioni.

Neni 11
FITIMI,NDARJA E TIJ.

Fitimi që rezulton nga aktiviteti i shoqerise, ndahet midis ortakeve, pasi me pare të jënë zbritur nga të ardhurat, shpenzimet e nevojshme si; detyrime ndaj të tretteve, tatime, taksa etj.Pjesët e fitimit përcaktohen sipas kontributit të pjeseve të secilit ortak për krijimin e kapitalit themeltar dhe perkatesisht:

Ortaku Vilson Ahmeti 50% Ortaku Alban Peza 50%

Perballohen prej tyre humbjet e shoqerise, deri në kufirin e vlerave të kontributit për krijimin e kapitalit themeltar.

Neni 12
FONDI "REZERVE E DOMOSDOSHME"

Palet bien dakort që nga fitimi i rezervuar gjatë vitit financiar, pasi të jënë zbritur po të jete e nevojshme, humbjet e vitit të mëparshëm, të lenë menjane një shumë me vlerë të pakten sa 1/20 e tij, e destinuar për formimin e fondit rezerve, "rezerva e domosdoshme", i cili do të shërbejë për kapitalizim të fitimeve, përballim të nevojave të domosdoshme, etj.Kjo lenie menjane nuk është e detyrueshme kur arrijnë në 1/10 e kapitalit themeltar të shoqerise(neni 213,Ligjit 7638 date 19.11.1992.)

Neni 13
STRUKTURA ORGANIKE E PUNESIMIT

Shoqeria lidh kontrata pune, individuale ose kolektive me personat e punësuar në baze të dispozitave ligjore dhe akteve nenligjore, që rregullojnë marrëdhëniet e punës në Republikën e Shqipërisë.Hartimi i Organikave dhe krijimi e vendeve të punës, do të bëhet me Vendim të Asamblese së shoqerise.

Neni 14
TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT THEMELTAR

Pjesët e kapitalit janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakeve, në rrugë trashëgimije e ndërmjet bashkeshortëve.Per transferimin e pjeseve në persona të trete, dhe procedurat e miratimit respektohet neni 47, Ligjit 7638 date 19.11.1992.

Neni 15
PRISHJA E SHOQERISE


Shoqeria prishet


- me plotesimin e afatit, te percaktuar si kohezgjatje e veprimtarise ne kete Statut,
- per cdo rast tjeter te parashikuar nga dispozitat perkatese te Ligjit 7638 date 19.11.1992, qe rregullon keto veprimtari.

Neni 16
DISPOZITA TE FUNDIT.

Kompetente per gjykimin e mosmarreshjeve midis ortakeve eshte gjykata e shkalles se pare Tirane. Sa me siper statuti nenshkruhet nga palet me vullnetin e tyre te plote e te lire, pa asnje verejtje duke u garantuar edhe respektimi I neneve te tij.

ORTAKET:

1. Vilson Ahmeti
emri, mbiemri, firma


2. ALBAN PEZA
emri, mbiemri, firma


REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr 5289 rep

Nr 2 kol

VERTETIM

Ne Tirane, sot me date 26/10/ 2004, para meje noter Vangjel Dera
U paraqiten personalisht z Vilson Ahmeti, biri Faikut, dl.05.09.1951, lindur ne Fier dhe banues ne Tirane, rruga Vaso Pasha nr.14/23, identifikuar me nr. dokumenti EV 218870 dhe zoti Alban Peza, biri ganiut, dl.25.08.1970, lindur e banues ne Tirane, rruga Labinoti nr.82, identifikuar me nr. dokumenti 0383132, te dy me zotesi te plote per te vepruar qe kerkuan vertetimin e nenshkrimeve te vena ne Statutin e shoqerise. Pasi u binda se kane shprehur vullnetin e tyre te lire dhe aktin e gjej ne pajtim me ligjin, nenshkruaj dhe vertetoj rregullisht.

NOTER

